



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 17.06.2013
Nr. 0204-753

PËR: Haki Rugova, Kryetar i Komunës së Istogut
Demë Çeta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË ISTOGUT, 01 Nr. 25 /2013 , Pranuar me datë, 11.06.2013

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01 Nr. 25 /2013 të miratuar me datë 31.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01 Nr. 25 /2013, miratohet Plani për Menaxhimin e Mbeturinave.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL.
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 17 .06.2013
br. 0204-753

Za: Haki Rugova, Gradonačelnik opštine Istok
Demë Çeta , Predsedavajući Skupštine opštine Istok

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Isatok , 01 br. 25 /2013 , primljeno dana ,
11.06.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01 br. 25 /2013 odobreno dana 31.05.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka 01 br. 25 /2013, usvaja se plan za upravljanje otpadom .

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.

 Republika e Kosovës Rebulikka Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPSTINA OPSTINE		 Komuna e Istogut Opstina Istok Istog Municipality
	01 Nr.25/2013	Data: 31.05.2013	

Kuvendi i Komunës së Istogut, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja l) lidhur me nenin 17 shkronja f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28/2008) në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2013, shqyrtoi Planin e Menaxhimit të mbeturinave të paraqitur nga Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim dhe mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani për Menaxhimin e Mbeturinave pa vërejte.
- II. Plani i menaxhimit është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
- III. Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim në bashkëpunim me kompaninë "Ambienti", në Istog do të kujdesen për zbatimin e këtij Plani për Menaxhimin e Mbeturinave.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.
- V. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetarit të Komunës, Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, kompanisë "Ambienti", në Istog dhe një kopje në arkivin e kuvendit.



Kryesuesi,
Demë Ceta



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipal Istog

MENAXHIMI I

MBETURINAVE NE KOMUNËN E ISTOGUT

Istog, maj 2013

MENAXHIMI I MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS ISTOG-DRAFT

Përmbajtja

Historiku i ISTOGUT.....	3
Pozita Gjeografike.....	3
Shtirja e Vendbanimeve Sipas Madhësisë.....	5
Çka janë mbeturinat.....	6
Klasifikimi dhe llojet e mbeturinave.....	6
Sipas ligjit për mbeturina ,llojet e mbeturinave janë :.....	6
Ne bërë të rrezikshmërisë dhe ekspozimit mbeturinat ndahen në :.....	6
Përfitimet nga Riciklimi në përgjithësi.....	9
LLOJET E MATERIALEVE TË RICIKLUESHME.....	9
Llojet e materialeve të riciklueshme.....	10
SHPERNDARJA E KONTINIERVE DHE KOSTOJA E KTI PROJEKTIT.....	13
Gjendja aktuale me grumbullimin dhe trajtimin mbeturinave në komunën e Istogut.....	13
Analiza e situatës.....	13
Ofrimi i shërbimeve.....	15
Grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.....	16
Fshirjen e rrugëve.....	16
Larjen e rrugëve.....	16
Shërbimet tjera.....	16
Plani i investimeve 2012--2013.....	16
OBJEKTIVAT.....	17
Përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave do ta bëjmë përmes këtyre masave.....	17
Menaxhimi i shërbimit të pastrimit të mbeturinave në ekonominë familjare.....	17
Përmirësimi dhe zgjerimi i aktivitetit të ndërmarrjes NPL AMBIENTI.....	18
Fushata sensibilizuese.....	23

HISTORIKU I ISTOGUT

Komuna e Istogut shtrihet në pjesën veriore të rrafshit të Dukagjinit. Komuna, në veri-perëndim kufizohet me Malin e Zi dhe Serbinë, në veri-lindje me komunën e Zubin Potokut, në lindje me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës dhe në jug-perëndim me komunën e Pejës. Ka sipërfaqe prej 453.84 km². Qendër komunale është qyteti Istog. Istogu ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, e hapur në të gjitha anët, më përjashtim të pjesës veriore e cila është e rrethuar më male të larta më lartësi mbidetare përtej 2.000 metrave. Më një infrastrukturë të mirë rrugore, që i mundëson komunikim të mirë më trevat tjera të Kosovës.

Ky territor, në aspektin gjeografik dhe etno-kulturor njihet si Podgur. Si nocion, Podguri është një nën krahinë etnografike që zë pozitën veriore të Rrafshit të Dukagjinit. Kufizimi gjeografik i Podgurit fillon me burimin e lumit Drini i Bardhë, ngjitet në majën e Rusolisë, vazhdon me masivin e maleve të Moknës, ndërsa kufiri lindor e juglindor është lumi Gujavç. Takimi i lumit Gujavç me lumin Istogu dhe me Drinin e Bardhë e përmyll gjeografikisht Trevën e Podgurit. Popullata autoktone e ka emërtuar "Pod i gurit" shkëmbin i cili i detyron tri burimet e ujit Istogun, Vrellën dhe Drinin e Bardhë të shpërthejnë në të njëjtën lartësi mbidetare. Istogu gjendet në qendër të Podgurit.

Pozita gjeografike, klima, pasurit natyrore, kanë kushtëzuar që Istogu të jetë i banuar që nga lashtësia. Ai ishte pjesë integrale e hapësirës ilire shqiptare. Në territorin e komunës së Istogut janë gjetur gjurmë vendbanimesh që datojnë edhe nga parahistoria. Istogu është i pasur po ashtu më vlera ëmblematike të trashëgimisë së kulturës materiale dhe shpirtërore.

Rrethi i Istogut në kuptimin e sotëm administrativ është formuar më 1913, pas pushtimit të Kosovës nga ana e ushtrive serbo-malazeze. Istogu si qendër e rrethit ka funksionuar prej vitit 1912 deri në vitin 1947. Më 1947 qendra u transferua në Gurakoc. Më 1 janar të vitit 1960, u bë edhe një riorganizim i organeve lokale të pushtetit, kështu që në tërë territorin e Kosovës u suprimuan të gjitha rrethet. Pas suprimimit, u bashkuan komunat Istog e Gjuraqoc, me qendër në Istog për të formuar njësinë e administrimit lokal ashtu si funksionon edhe sot. Me shtimin e përmbytjeve administrative, arsimore e kulturore, Istogu në dhjetor 1978 shpallet qytet.

Pozita Gjeografike

Istogu është një komunë, afër bjeshkëve të Moknës, që shtrihet në pjesën veri - perëndimore të Kosovës dhe në pjesën veriore të Dukagjinit, me lartësi mbidetare gjer në 2 155 m. Istogu ka sipërfaqe prej 453.84 km². Në lindje kufizohet me komunën e Skenderajt, në jug me komunën e Klinës, në jug - perëndim dhe perëndim me Komunën e Pejës. Në veri me Malin e Zi dhe Serbinë si dhe në veri - lindje, kufizohet me komunën e Zubin Potokut.

Komuna e Istogut ka një pozitë të përshtatshme gjeografike, dhe është e hapur në të gjitha anët me përjashtim të pjesës veriore e cila është e rrethuar me male të larta, Bjeshkë të thata dhe Mokna me një lartësi mbidetare gjer në 2155 m, dhe është e lidhur me rrugë të asfaltuara me të gjitha komunat e Kosovës.

Zona e FUSHËS mbulon afërsisht 44% të territorit, ku shtrihen numri më i madh i vendbanimeve, e banuar me rreth 62% të numrit të tërësishëm të banorëve të komunës së Istogut. Kjo pjesë e Komunës është kryesisht rrafshinore me lartësi mbidetare 400 - 500 m. Është e rrethuar me peizazhe të bukura kodrinore të Rrëzës, ngjyra tërheqëse të gjelbërimit dhe prapavijë kodrinore si element identifikues i komunës. Në kuadër të kësaj zone shtrihen dy subëqendrat - Gurakoci dhe Banja që i ofrojnë kësaj zone shërbime të mira dhe ndikojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të qendrave dhe vendbanimeve tjera. Në këtë zonë kryqëzohen dy rrugët regjionale, rruga Mitrovicë - Pejë dhe Prishtinë - Istog.

Zona e emëruar "Rrëza" përfshinë vendbanime që shtrihen ndërmjet zonës rrafshinore "Fushës" dhe zonës kodrinore "Bjeshkës" si dhe paraqet "kufirin" ndërmjet rrafshit dhe kodrës. Ka një shtrirje vijore, me lartësi mbidetare prej 500 deri 650 m. Kjo zonë përfshinë 17% të sipërfaqes së tërësishme të komunës. Përgjatë tërë territorit kjo zonë përshkohet nga rruga regjionale Mitrovicë-Pejë-Mali i Zi. Zona "Bjeshka" përfshinë zonën veriore të komunës dhe përbëhet nga malet dhe pjesërisht nga toka bujqësore, livadhet dhe kullosat. Kjo zonë mbulon afërsisht 39% të sipërfaqes së tërësishme të komunës ndërsa ka një dendësi shumë të ulët të popullsisë vetëm 4% e numrit të tërësishëm të banorëve të komunës.

Territori i komunës së Istogut karakterizohet me klimë kontinentale të butë në të cilën ndikim të madh ka afërsia e kurorës malore të Bjeshkëve të Thata nga pjesa veriore që ka ndikim të madh në ndryshimin e shpeshtë të temperaturës gjatë ditës. Ky territor nuk ndryshon shumë sipas kushteve të temperaturës nga territoret tjera të pjesës veriore të rrafshit të Dukagjinit të cilat janë në një pjesë të madhe nën ndikimin e klimës kontinentale dhe që kanë më pakë nxehtësi dhe më tepër të reshura. Temperaturat mesatare mujore sillen prej 0.5 °C në janar deri në 23.3°C në gushtë. Temperatura mesatare vjetore është 11.3°C ndërsa në periodën vegetative 17.6° C. Sasia vjetore e të reshurave është mesatarisht afro 740 mm, që këtij territori i japin karakterin e lagshtë. Mirëpo renditja e tyre gjatë periudhës vegetative është 307mm ose 41% dhe jashtë periudhës vegetative 431 mm ose 59%, e sidomos gjatë muajve të verës (qershor-gushtë) me afro 147mm (20% nga të reshurat vjetore). Kështu që gjatë periudhës vegetative paraqitet deficit i lagshtisë në tokë për zhvillimin normal të kulturave bujqësore dhe si faktorë kufizues në prodhimtarinë bujqësore.

Shtirirja e vendbanimeve sipas madhësisë.

Vendbanimet në komunën e Istogut i kemi ndarë në 4 grupe:

Vendbanimet	Numri i banorëve
Vendbanimet e vogla	0---300
Vendbanimet e mesme	300---2000
Vendbanimet e mëdha	2000---3000
Vendbanimet rurale	mbi --- 3000

Në kategorinë e parë prej 0-300 banorë ,në komunën e Istogut ,sipas statistikave,janë 12 vendbanime. Në këtë kategori në pjesën perëndimore janë të vendosura 12 fshatra, këto janë: Bellopoja, Belica,Dubova e vogël, Llukavci i thatë, Mojstiri, Osojani, Polana, Sineja, Shalinovica, Koshi, Tuqepi, Veriqi i Ri.

Në kategorinë e vendbanimeve të mesme 300-2000 banorë, në komunën e Istogut i kemi 29 fshatra :Banjica, Caralluka, Dobrusha, Dragoleci, Dreja, Dubova, Llukave i Begut, Muzhevina, Orroberda, Prekalla, Pigoda, , Serbobrani, Saradrani, Sudenica, Syrigana, Kaliqani, Kashica, Kernina, , Lubova, Lubozhda, Llugat, Shushica, Tomoci, Trubuhoci, Uqa, Veriqi, Zabllaqi, Zallqi, Zhakova.

Në kategorinë e tretë prej 2000-3000 banorë, ne kete grup te vendbanimeve hyn vendbanimet e mëdha rurale siq janë, Istogu i Poshtëm, Rakoshi, , Cerca dhe Kovraga.

Ne kategorinë e vendbanimeve me të mëdha së 3000 banorë hynë Istogu si qendër kryesore e të gjitha vendbanimeve për rreth, vendbanimi i Istogut është i vendosur në pjesën veriore të Komunës dhe Gurakoci, Banja dhe Vrella si qendra urbane .

ÇKA JANË MBETURINAT

Definicioni dhe nocionet për mbeturina

Mbeturinë - është çdo substancë ose lëndë e specifikuar të cilën zotëruesi e hedhë , mendon ta hedhë ose është i detyruar ta hedhë.

Hedhurinë-është çdo pjesë e mbeturinës, lëndë ose substancë e cila mbetet pas përpunimit të mbeturinës, kompozimet ose elementet të cilat nuk kanë me vlerë për përdorim .

Administrimi i mbeturinave-nënkupton mbledhjen, grumbullimin, transportimin, përpunimin ,trajtimin dhe deponimin e mbeturinave duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e operacioneve të tilla si dhe përkujdesjen pas mbylljes së deponove.

Riciklimi-është proces për trajtimin dhe ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave

Trajtimi i mbeturinave-përfshinë proceset : fizike,kimike,biologjike,termale,ndarjen e mbeturinave në lloje ,me qëllim të pakësimit të vëllimit dhe karakteristikave të dëmshme të mbeturinave .

Grumbullimi i mbeturinave - është aktivitet sistematik i mbledhjes së mbeturinave me qëllim të trajtimit të mëvonshëm ose deponimit.

Klasifikimi dhe llojet e mbeturinave

Sipas ligjit për mbeturina llojet e mbeturinave janë :

- Mbeturinat komunale
- Mbeturinat komerciale
- Mbeturinat industriale

Ne bëz të rrezikshmërisë dhe ekspozimit mbeturinat ndahen në :

- Mbeturina inerte
- Mbeturinat e pa rrezikshme
- Mbeturinat e rrezikshme

Mbeturinat komunale : janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitete tjera, te cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë .

Mbeturinat komerciale : janë mbeturina të cilat vijnë nga objektet që përdoren vetëm apo kryesisht për qëllimet e tregut ose biznesit ,sportit,edukimit,rekreacionit,por nuk përfaqësojnë mbeturinat komunale dhe ato industriale.

Mbeturinat industriale : janë mbeturina të cilat prodhohen nga aktivitetet ose proceset industriale ose të prodhimtarisë artizanale dhe aktivitetet tjera prodhuese .

Mbeturinat inerte: janë mbeturina të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar, mbeturinat inerte nuk treten, nuk ndizen, ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht .

Mbeturinat e pa rrezikshme: janë mbeturina të cilat nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme .

Mbeturinat e rrezikshme: janë mbeturina të cilat kanë së paku njërin nga këto karakteristika si më poshtë: eksplozive, oksiduese, të ndezshme, toksike, komerciale ,korrozive, irituese, dëmtues, infektues ,teratogjene, mutagjenike ,liron gazra toksike në kontakt me ujë ,ajrin etj. Një ambient i pastër dhe i shëndetshëm është pjesë dhe ngastër e begatisë dhe cilësisë së jetës, që ne dëshirojmë për veten tonë tani dhe për fëmijët tanë në të ardhmen. Shkallët që ngjisin e zbrisim përditë në pallatin tonë, rrugët e shtëpisë, oborri i shkollës, përtej qytetit etj., kërkojnë dashuri e kujdes prej nesh, në mënyrë që të bëhen për ne mjedisi, ku të bashkëjetojmë me ajër të pastër, ushqim të shëndetshëm, duke u kthyer në hapësira mikpritëse të bashkëjetesës tonë qytetare. Mbeturinat nuk janë vetëm gjëra të cilat ne nuk na nevojiten më, as gjëra që na mbesin nga prodhimi i mallrave të ndryshme. Ato janë edhe gjëra me të cilat ne mund të përfitojmë.

Eliminimi i mbeturinave urbane përbën një hallkë jetike në konceptin fillim-përfundim të menaxhimit të mbeturinave urbane. Theksi i tanishëm mbi parandalimin e ndotjes, si dhe zhvillimi i teknologjive të trajtimit ka si rezultat pakësimin e volumit të mbeturinave urbane, të cilat duhet të eliminohen. Volumet e mbeturinave janë parashikuar të rriten vazhdimisht përderisa mos të merren veprime që ta zgjidhin këtë problem. Të gjithë prodhojnë mbetje. Parandalimi i mbeturinave do të jetë një element kyç i një politike të integruar. Masa të forta fillimisht nevojiten për të nxitur ripërdorimin, zvogëlimin dhe riciklimin dhe përpunimin e mbetjeve, e cila quhet ndryshe edhe "hierarkia e mbetjeve".

Riciklimi i mbetjeve është një mundësi ekologjike dhe fitimprurëse në menaxhimin e mbetjeve ndaj mundësive të tjera, si vend gërmimesh ose djegie. Edukimi i qytetarëve për të reduktuar, ricikluar mbetje urbane nuk është zgjidhja e plotë, por është një fillim i mbarë. Riciklo për të kursyer energji, material, sipërfaqe etj . Metodatat ekologjike të


trajtimit të M.U. sot në botë aplikohen disa metoda për trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane të cilat ndahen :

A. Trajtimi ekologjik-ekonomik

Në trajtimin ekologjik përfshihen

1. Reduktim
2. Ripërdorim
3. Riciklim
4. Kompostim
5. Vend groposje e Kontrolluar

Metoda Ekologjike të Trajtimit të Mbetjeve Urbane Riciklimi



PËRFITIMET NGA RIKIKLIMI NË PËRGJITHËSI

- Zvogëlon nevojën për hapësira të vend groposjes;
- Kursen taksat;
- Kursen harxhimit të energjisë me 2/3..;
- Zvogëlon ndotjen;
- Mbron burimet tona të pamjaftueshme;
- E bën ambientin një vend të këndshëm për të jetuar;

LLOJET E MATERIALEVE TË RIKIKLUESHME

Të përgjithshme

Lista potenciale e materialeve ricikluese vazhdon të rritet, meqenëse zhvillimi teknologjik bën që më shumë materiale të riciklohen, duke u klasifikuar dhe grupuar në tri kategori:

1. *Kategoria e parë* konsiston në elementë që ndodhen me shumicë dhe në sasi të pakufizuar në produktet e konsumit. Ushqimet janë një shembull i këtij produkti, sapunët konsumohen për qëllim pastrimi, shkarkohen në tubat e shkarkimit dhe precipiton si kripë e patretshme e kalciumit dhe përfundimisht biodegradon. Material të kësaj kategorie të riciklueshme shkarkohen në natyrë dhe riciklohen përmes proceseve natyrorë ose me investime fare të vogla si janë p.sh llumrat e ujërave të ndotur urbanë të përdorur si pleh organik.

2. *Kategoria e dytë* e materialeve të riciklueshme konsiston në elementë që nuk janë me pakicë por të përdorur në forma të ndryshme pengojnë riciklimin. Druri është një shembull tipik. Të paktën ato pjesë drurësh që janë përdorur në godina që më pas shëmben mund dhe duhen ricikluar. Shembulli më i mirë i kësaj klase është letra. Fibrat e letës mund të riciklohen mbi pesë herë dhe janë të një natyre të tillë që lehtëson riciklimin. Më tepër se 1/3 e produktit botëror të letës është me origjinë nga riciklimi dhe ky fraksion do të rritet mbi 50% në dekadat e ardhshme. Shkaku kryesor i riciklimit të letës nuk është nevoja për dru për të prodhuar letër të virgjër por nevojat në rritje për vend depozitimit të mbeturinave të letës. Faktorët që komplikojnë riciklimin e letës janë ngjitësit, bojërat, kapëset, yndyrërat dhe papastërti të tjera si edhe tendenca që

kanë fibrat e letrës së ricikluar për t'u bërë më të shtrira, më pak të forta dhe më të thata sesa fibrat e sapo prodhuara nga drurët.

3. *Kategoria e tretë* e materialeve të riciklueshëm konsiston në ata elementë, kryesisht metale, rezervat botërore të të cilëve janë të ulëta. Kromi, platini dhe gjithë grupi i metaleve të çmuar janë shembuj të këtyre elementëve. Duke dhënë maksimumin e mundësive për riciklimin veçanërisht përmes mekanizmave me çmime të lartë duket se burimet natyrore të këtyre metaleve nuk do të shterojnë në sajë të riciklimit në një të ardhme të afërt.

Llojet e materialeve të riciklueshme

Riciklimi i plastikëve

Që pas Luftës së II Botërore plastiket janë bërë një problem i madh në mbeturinat urbane. Pjesa më e madhe e plastikëve nuk biodegradojnë mirë ose aspak dhe kontributi i tyre në mbeturinat solide është i madh në fushat e grumbullimit të plehrave edhe pas biodegradimit të mbeturinave të tjera. Në sajë të varietetit të përbërjes, papastërtive, pigmenteve përbërës dhe faktorëve të tjerë, riciklimi i plastikëve në mbetjet e ngurta urbane është një synim që duket premtues. Teknologjia e riciklimit të plastikëve të pas-konsumit është zhvilluar më shpejt sesa teknologjia e riciklimit të materialeve të tjerë këtë gjysmë shekull. Megjithatë, vetëm pesë vitet e fundit të dhjetëvjeçarit të kaluar, post-konsumet plastikë të polietilenit me densitet të lartë (HDPE) dhe teraftelati polietileni (PET) janë konsideruar si të riciklueshëm. Këto dy prodhime, sidomos plastiket HDPE të shisheve të qumështit dhe PET i pastër, tani në treg zënë një vend të rëndësishëm. Tregu për plastiket është më pak i zhvilluari ndërmjet tregjeve të riciklimit për shkak të aftësive të vona të riciklimit. Megjithatë, shumë plastika janë dendësuar, duke i petëzuar, duke i bërë deng ose duke i copëtuar dhe më vonë iu shiten konvertuesve. Plastiket ndahen në dy klasa fakt ky që ndikon shumë në riciklimin e tyre.

Termoplastikët janë ato të cilat bëhen fluide kur ngrohen dhe ngurtësohen kur ftohen. Përderisa ato mund të nxehen, të shkrihen dhe të riformohen shumë herë, termoplastikët janë shumë të riciklueshme. Termoplastikat e riciklueshme përfshijnë: Polialkenet (polietilenet dhe polipropilenet me dendësi të ulët dhe të lartë), Polivinilkloridet (PVC), që përdoren në sasi të mëdha për të prodhuar tuba plastikë, produkte shtëpiakë dhe materiale të tjerë rezistentë.

Polietilenet, polistirenet dhe tereftalatet.

Ambalazhet plastikë kryesisht prodhohen prej termoplastike dhe potencialisht janë të riciklueshëm. Për fat të mirë nga pikëpamja e riciklimit termoplastikat përbëjnë sasinë më të madhe të plastikave të përdorura.

Plastikët termorezistente janë plastikët, të cilat formohen nga lidhjet midis njësive polimerike kur ato ngrohen. Këto lidhje formojnë cepat e plastikëve të cilat nuk zbuten kur ngrohen. Megjithatë plastikët termorezistente nuk mund të riciklohen ato mund të digjen për të përfutur nxehtësi prej tyre. Një klasë e rëndësishme e plastikëve termorezistente janë epoksi rezinat që karakterizohen nga një atom oksigjeni i vendosur midis dy atomeve karbon fqinjë (1,2-epoxide ose oxirane). Epoxidet janë përdorur gjerësisht në materiale të përzier të kombinuar me fibra qelqi ose grafiti. Materiale të tjerë plastikë termorezistentë përfshijnë polimerët fenolikë me lidhje të kryqëzuar, disa lloj poliestërësh dhe silikonet. Ndotësit e plastikës duhen marrë në konsideratë p.sh boja e përdorur për të ngjyrosur objektet plastikë është një ndotës tipik, ngjitësit e ndryshëm veshjet e llojeve të ndryshme mund të sillen si ndotës. Materiale të këtij lloji mund të dobësojnë vetitë ricikluese të materialit ose të kthehet në gasë, kur plastika nxehet për riciklim.

Lëkurëzat

Një material i riciklueshëm është edhe lëkura. Polimerët sintetikë që prodhohen tashmë prodhojnë sasi të mëdha lëkure dhe gomash të depozituara në vende të ndryshme. Goma dhe lëkura sintetike është një hidrokarbon polimerikë që mund të përmbajë edhe materiale të tjerë si karboni i zi mbushës. Disa lloje lëkurash mund të groposen / të riciklohen. Një komplikim madhor në djegien dhe riciklimin e lëkurëzave dhe gomave është edhe prezenca e unazave të hekurta në shumë goma radiale. Hekuri i pranishëm dëmton pajisjet grirëse dhe mekanizmat transportues si në proceset e riciklimit ashtu edhe të djegies.

Letra

Letrat e përmirësuara (rigjeneruara) dhe letrat e prodhuara blihen dhe shiten ndërmjet një rrjeti të përpunuesve lokalë dhe komisionarëve dhe i vënë këto materiale në shitje dhe i eksportojnë te fabrikat e letrës. Fabrikat, gjithashtu blejnë materiale drejtpërdrejtë nga koleksionuesit. Si letër e përmirësuar (rigjeneruar) janë klasifikuar:

- letra e gazetave, kartoni i valëzuar (i rrudhur),
- letrat e përziera (duke përfshirë gazetat,
- hedhurina ose mbetjet e postimit, si dhe kartonët e kutive,
- niveli i lartë i çngjyrosjes (letra e bardhe e zyrave), dhe

- zëvendësuesi i brumit (zakonisht karton i trashë).

Fabrikuesit e letrës, pjesa më e madhe e përdoruesve të letrës së përmirësuar, e përdorin materialin si lëndë të parë për të prodhuar letrën e ricikluar dhe produktet e letrës, si letër gazete, ashkël kartoni, karton me rrudhje mesatare, letra të holla. Letra e copëtuar mund të përdoret për të bërë shtresa kafshësh, hidro-produkte, brumin e letrës që prodhohet më vonë, si dhe izolues apo mbrojtës celulozoikë.

Qelqi

Tregjet e qelqit të ricikluar mundësojnë një ndotje të vogël. Organizuesit e programit të riciklimit duhet të kenë si qëllim cilësinë e lartë të qelqit të ricikluar. Tregjet alternativë të qelqit përfshijnë qelqo-asfaltin, artin e qelqit, shkrirjen e rërës dhe nga pasindustria, xhamat e dritareve, si dhe veshje (mbrojtje) qelqore. Tregjet e qelqit të përmirësuar janë përqendruar dhe këmbëngulin për qelqin ngjyrë kafe dhe ambalazhe të qartë.

NPL AMBIENTI - Istog në vazhdim e aktiviteteve për vetëdijësimin dhe përmirësimin e gjendjes së ambientit përkatësisht të mbeturinave në Istog, ka marrë iniciativë që të bëjë riciklimin e mbeturinave. Ky projekt së pari do të implementohet në institucione komunale, shkolla, shtëpi të shëndetit, hotelieri, pishina, pompa të benzinës, çerdhe fëmijësh etj.

Me këtë projekt synojmë që të arrihen ndërgjegjësimi i qytetarëve për rëndësinë e riciklimit të mbeturinave dhe përfitimet që dalin nga riciklimi.

Riciklimi i mbeturinave do të bëhet duke i pajisur të gjitha institucionet me kontejner 120 l. Riciklimi do të bëhet duke i klasifikuar në kontejner të veçantë mbeturinat : Organike, Qelqin, Plastiken, mbetjet medicinale, Hidrokarburet etj.

Për realizimin e këtij projekti nevojiten së paku 370 kontejner 120 L .

Këtij projekt duhet ti paraprij një fushat senzibilizuese me të gjitha kategoritë e lartcekura duke filluar me nxënësit e shkollave fillore në ciklin e ulët, në ciklin e mesëm të ulët, si dhe në atë të mesëm. Fushata do të përqendrohet kryesisht në çështjet e ambientit, rëndësinë e mbrojtjes së tij në fokus të veçantë do të jenë mbeturinat.

Rreziku që vjen nga përhapja e mbeturinave, efektet negative në shëndetin e njeriut, rreziku nga mbeturinat medicinale në qoftë se hedhen në vende jo adekuate, pasojat për mjedisin që vijnë nga metalet e rënda. Fushata do të bëhet edhe përmes mediave elektronike dhe të shkruara. Përmes fletushkave të ndryshme, billbordeve të vendosur nëpër qytet etj.

SHPERNDARJA E KONTINIERVE DHE KOSTOJA E KTI PROJEKTIT

Kategoria	Numri i kontejnerëve	Shuma €
shkolla (të mesme + Filllore)	120	2640
Shtëpitë e shëndetit + Ambulancat	55	1210
Pompat e benzines	70	1540
Restorante e të ngjajshme	100	2200
Qendra sociale + Banesat sociale	10	220
Çerdhet e fëmije	15	330
Gjithsejtë	370	8140

GJENDJA AKTUALE ME GRUMBULLIMIN DHE TRAJTIMIN MBETURINAVE NE KOMUNËN E ISTOGUT

Analiza e situatës

Aktiviteti kryesor i KRM AMBIENTI ne Istog është zbrazja e kontejnerëve 1.1 m³ për mbeturina dhe bartja e tyre në deponinë Komunale në Tuqep të Istogut .

KRM AMBIENTI në Istog ofron shërbime në zonat urbane dhe ato rurale. Në zonat urbane shërbimet arrihen deri në 90% , ndërsa në zonat rurale afërsisht 20.% shërbimet ofrohen në bazë të marrëveshjeve të veçanta me kontrata .

Si punë kontraktuese më e rëndësishme për mirëmbajtjen e ambientit mundë të ceket kontrata e Kuvendit komunal me "ambientin" për fshirjen e rrugëve dhe trotuareve si dhe larjen e rrugëve të qytetit sipas marrëveshjes , gjithashtu ka shërbime të kontraktuara me disa biznese si hotele etj. Të cilat gjinden jashtë qytetit .

KRM AMBIENTI në Istog menaxhon me 23 punëtor , posedon makinerinë adekuate për kryerjen e shërbimeve që i ofrojmë ,por kjo makineri që ishte donacion i shoqatave të ndryshme nga jashtë tani veç janë të amortizuara ,prandaj edhe shpenzimet operative si ; Karburanti , mirëmbajtja etj. janë të mëdha .

AMBIENTI Problem kryesor e ka inkasimin pasi që qytetarët e Istogut në masë të madhe nuk i kryejnë obligimet që i kanë ndaj kompanisë .

AMBIENTI aktualisht ofron shërbime për këto kategori





Tabela Nr 3 Paraqet numrin e klientëve të cilët janë të kyçur në sistem

Kategoritë	Numri i klientëve
Ekonomit familjare	1143
Bizneset	352
Institucionet + Burgu dhe F.S.K. në Dubravë KK Istog	52

MENAXHIMI I MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS ISTOG-DRAFT




OFRIMI I SHËRBIMEVE

Mënyra ofrimit të shërbimeve

Kompania ofron shërbime në bazë të marrëveshjeve paraprase me qytetar siç janë

- 1) Grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave ,
- 2) Fshirjen e rrugëve .
- 3) Larjen e rrugëve .
- 4) Mirëmbajtjen e parqeve
- 5) Mirëmbajtjen e varrezave



GRUMBULLIMIN DHE TRANSPORTIMIN E MBETURINAVE

Grumbullimin e mbeturinave e bëjmë në dy mënyra si ; shpërndarja e kontejnerëve me vëllim 1.1 m³ dhe të atyre 7 m³, Ndërsa grumbullimi me qese të plastikës mbetet synim të aplikohet më shumë në arvizni .

Fshirjen e rrugëve

Fshirjen e rrugëve dhe trotuareve bëhet në bazë të marrëveshjes me komunën dhe "Abientin". Fshirjen e bëjmë ne baza ditore.

Aktualisht pastrojmë 26600 m² ndërsa pastrimin e tregut e bëjmë një herë ne javë me sipërfaqe 3000 m²

Larjen e rrugëve

Larjen e rrugëve e bëjmë në marrëveshje me komunën dhe "Ambientin", larja bëhet sipas marrëveshjes dhe sipas nevojës.

Shërbimet tjera

Për shërbimet tjera si ; Pastrimin e borës , mirëmbajtjen e parqeve dhe mirëmbajtjen e varrezave ne si komunën nuk kemi marrëveshje me kompaninë që ti kryejmë këto shërbime por shpresojmë që në të ardhmen ti kryem edhe këto shërbime me kontratë të rregullt.

Plani i investimeve 2012--2013

Vlen te theksohet se sa i përket investimeve , kjo do të arrihet vetëm nëse gjenden donatorë sepse sipas gjendjes momentale financiare kompania nuk është në gjendje që të bëjë ndonjë investim kapital. Në vijim do të pasqyrojmë supozimet për vitin 2013 si dhe planifikimet për vitin 2014.

NPL ambienti ka nevojë për këto investime ;

OBJEKTIVAT

KOMUNA në bashkëpunim me NPL AMBIENTIN si objektiv parësorë ka përmirësimin e shërbimeve që i ofron, që të ketë shërbime sa më efikase , dhe në të njëjtën kohë të bëjë zgjerimin gradual të shërbimeve në tërë territorin e Istogut , duke ofruar shërbime sa më efikase nëse do të japim një pamje tjetër komunës tonë por në veçanti qytetit të Istogut. Istogun do ta bëjmë që të jetë shembull për komunat tjera sa i përket pastërtisë dhe menaxhimit të mbeturinave.

PËRMIRËSIMIN E MENAXHIMIT TE MBETURINAVE DO TA BËJMË PËRMES KËTYRE MASAVE


- ❖ Menaxhimi i shërbimit të pastrimit të mbeturinave në ekonominë familjare,
- ❖ Menaxhimi i shërbimeve të pastrimit të mbeturinave në biznese,
- ❖ Rritjen e inkasimit.
- ❖ Plani i zhvillimit të stafit
- ❖ Fushatë senzibilizuese.

MENAXHIMI I SHËRBIMIT TË PASTRIMIT TË MBETURINAVE NË EKONOMINË FAMILJARE

Menaxhimi i shërbimit të mbeturinave në ekonominë familjare në zonat urbane e bëjmë në baza ditore , ndërsa në zonat rurale e bëjmë sipas marrëveshjes dhe sipas nevojës së paku një herë në javë , dy herë në muaj ose edhe një herë në muaj.

Numri i ekonomive familjare në komunën e Istogut është 6582 , ndërsa kompania mbulon vetëm 1143 ekonomi familjare

MENAXHIMI I MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS ISTOG-DRAFT



PËRMIRËSIMI DHE ZGJERIMI I AKTIVITETI TE NDËRMARRJES NPL AMBIENTI

KRM AMBIENTI në Istog në vitin 2013 synim parësor të vetin ka përmirësimin e shërbimeve dhe zgjerimin e shërbimeve që i ofron.


Zgjerimi i aktiviteteve do të behet në 3 etapa.

Ne etapën e parë përfshihen shërbimet që aktualisht i mbulojmë duke u zgjeruar në zonat që janë afër qytetit në këtë etapë do të përfshihen

MENAXHIMI I MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS ISTOG-DRAFT

Ne etapën e I do te përfshihen këto fshatra

Emri i vendbanimeve	Ekonomit familjare	Bizneset	Kontejnerët kolektiv 120 L
Istog	992	535	340-banesa
Vrellë	472	30	502
Studenicë	244	7	251
Kaliqan	149	5	154
Banje	277	135	412
Banjicë	105	5	110
Kashicë	93	7	100
Staradran	257	5	262
Trubuhoc	141	3	145
Zabllaq	79	2	81
Zallq	89	6	95
Gurrakoc	417	144	561
Tomoc	132	5	137
Rakosh	136	6	142
Dobrushë	242	7	249
Gjithësejt	3825	902	3541




Etapa	Koha e realizimit
I.	Janar , Shkurt ,Mars ,Prill

MENAXHIMI I MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS ISTOG-DRAFT

Ne etapën e II do të përfshihen këto fshatra

Emri i vendbanimit	Ekonomit familjare	Bizneset	Kontejnerët 120 L
Lluga	89	3	92
Llukac i Begut	192	2	194
Muzhevië	110	3	113
Dragolevci	71	4	75
Lubozhdë	165	3	168
Cerrcë	215	5	220
Lubovë	138	3	141
Prigodë	98	2	100
Istog i poshtem	107	3	110
Dubravë	124	2	126
Sinajë	40	3	43
Kovragë	124	3	127
Serbobran	53	1	54
Gjithsejt	1526	37	1563




Etapa	Koha e realizimit
II.	Maj, Qershor, Korrik ,Gusht.

MENAXHIMI I MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS ISTOG-DRAFT


Ne etapën e III do të përfshihen këto fshatra

Uqë	144	4	148
Shushicë	241	3	244
Syrigan	14	1	45
LL i Thatë	32	1	33
Orroberdë	198	2	200
Prekallë	63	1	64
Dubovë e vogël	49	2	51
Cerrallukë	94	3	97
Osojan	28	2	30
Drejë	61	1	62
Bellopojë	25	--	25
Zhakovë	51	--	51
Tuqep	3	--	3
Kosh	36	--	36
Veriq	76	--	76
Mojstir	42	2	44
Cerrkolezë	44	1	45
	1231	23	1254



Etapa	Koha e realizimit
III.	Shtatar , Tetor, Nentor Dhjetor

Ekonomit familjare dhe bizneset si pas etapave të realizimit.



13 Kostoja e përgjithshme për implementimin e projekti

Etapat	Artikulli	Sasa	Çmimi	Gjithsejtë
Etapa e par	Kontejner 120 L	3541	23 €	81443.00 €
Etapa e dyte	Kontejner 120 L	1563	23 €	35949.00 €
Etapa e tret	Kontejner 120 L	1254	23 €	28842.00 €
Kontejner për riciklim : Shkolla, shtëpi te shëndetit etj		49	23 €	1127.00 €
Totali		6407	23 €	147361.00 €

Për të arritur këtë qellim kërkohen investime të konsiderueshme, të cilat investime do të bëhen vetëm nëse gjenden donator, sepse kompania nuk posedon mjete financiare për këto investime.

FUSHATA SENZIBILIZUESE

Për rritjen dhe vetëdijesimin e qytetarëve mendojmë ta bëjmë një fushat sensibilizuese me qytetaret e Istogut në mënyrë që të rritet vetëdija për rëndësinë e një ambienti të pastër.

Fushatën do ta bëjmë përmes këtyre pikave në vijim;

- 1) Përmes kontakteve të drejtpërdrejt me qytetar .
- 2) Përmes mediave.
- 3) Përmes fletushkave.
- 4) Përmes postareve dhe billbordeve .
- 5) Përmes ligjëratave nëpër shkolla dhe institucione tjera.